



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 148, datë 28.09.2023

PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ PËR PERIUdhËN 2023-2025

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre” i ndryshuar, Udhëzimit nr.1 datë 24.05.2005 i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturor”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”, dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e krijimit të Këshillit Artistiko-Kulturor pranë Bashkisë Durrës me mandat dy vjeçar, për periudhën 2023-2025 me përbërjen si më poshtë:

1. Adrian	Gurra	Drejtor
2. Haig	Zacharjan	Kompozitor
3. Shpresa	Beqiraj	Piktor
4. Aldo	Aliaj	Koreograf
5. Shaban	Sinani	Studiues

6. Haxhi	Rama	Regjisor
7. Ermir	Dizdari	Dirigjent
8. Loer	Kume	Shkrimtar
9. Bujar	Qesja	Gazetar

- Miratimin e pagesës për çdo anëtar të Këshillit Artistiko-Kulturor në shumën prej 3500 lekë (tremijë e pesëqind lekë) për çdo mbledhje.
- Ky këshill do të ketë karakter këshillimor me mandat dy-vjeçar dhe do të mbledhet jo më shumë se gjashtë herë në vit.
- Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Artistiko-Kulturor do të përballohet nga shpenzimet operative (Art.602) të Bashkisë Durrës.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës Nr.125, datë 24.12.2020 “Për miratimin e ngritjes së Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, shfuqizohet.
- Ngarkohen Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria e Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.




KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 629/Prot.
6

Durrës, më 05.10.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.148 datë 28.09.2023 “Për miratimin e krijimit të Këshillit artistiko-kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij për periudhën 2023-2025”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

